

YENİLİKÇİ TÜRK HAREKET PARTİSİ
PARTIA TURKE E LËVIZJES NOVATORE
STATUTI

KAPITULLI I PARË
PARIMET E PËRGJITHSHME

Emri, Emblema dhe qendra e partisë
Neni 1

- 1.1. Duke u bazuar në normat e këtij statuti, emri i partisë së themeluar quhet: **YENİLİKÇİ TÜRK HAREKET PARTİSİ.**
- 1.2. Emblema e partisë, e simbolizon lëvizjen novatore. Hëna është projektuar me gjethe e cila karakterizon zhvillimin, si dhe në mes të tij është vendosur një yll. Emblema është dizajnuar me ngjyrë kuq e bardhë si dhe përfshinë edhe emrin e plotë të partisë.
- 1.3. Qendra e partisë është Prizreni.
- 1.4. Në të gjitha procedurat, punimet zyrtare dhe aktivitetet e saj partia do ta përdorë emrin si të tërë: Yenilikçi Türk Hareket Partisi, moton “Yenilikçi Hareket” (Lëvizja Novatore) dhe shkurtesën : “YTHP”.

Qëllimi, Objektivat dhe Programi
Neni 2

2.1. Qëllimi i themelimit:

Kjo është parti politike e cila do t'i shërbejë Komunitetit turk të Kosovës, i cila është faktor i ngritjes dhe i zhvillimit të Republikës së Kosovës, t'ia mundësojë të sheh me besim të ardhmen, të prodhojë dhe të zhvillojë politika novatore, demokratike dhe të bazuara në zhvillim, duke qëndruar besnik ndaj të drejtave të njeriut dhe parimeve të së Drejtës ndërkombëtare dhe të zhvillojë politika që do t'i mbrojnë dhe zhvillojë të drejtat kushtetuese dhe ligjore të Komunitetit turk të Kosovës.

2.2. Objektivat

2.2.1. Mbrojtja dhe zhvillimi i të gjitha të drejtave që i njihen Komunitetit turk dhe qytetarëve nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe ligjet e tjera;

2.2.2. Mbrojtja dhe zhvillimi i gjuhës, traditave dhe kulturës turke në të gjitha sferat dhe kuptimet;

2.2.3. Ta mundësojë shkollimin në gjuhën turke në sistemin arsimor publik në të gjitha sferat dhe ta mundësojë zhvillimin e tij;

2.2.4. Duke marrë parasysh prezencën dhe mirëqenien e komunitetit tonë, kudo qoftë në Kosovë, aty ku mbizotëron popullata turke, duhet të bëhet mundësimi i rrethanave të nevojshme për realizimin e punimeve të partisë si dhe nisjen e iniciativave politike dhe civile;

2.2.5. Zgjedhjen e përfaqësuesëve në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe në të gjitha komunat ku jetojnë (jeton komuniteti turk), ta ngrisin zërin e tyre në institucionet dhe organizatat publike;

2.2.6. Në themelet e Partisë mbizotëron respekti, harmonia dhe barazia. Për shkak të kësaj, të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë, kjo parti do t'i përkrahë dhe do t'i mbrojë të drejtat dhe liritë që njihen nga Kushtetuta dhe ligjet e Republikës së Kosovës, si: kultura, traditat dhe zhvillimi i arsimimit të tyre, si dhe ngritjen socio-ekonomike të ngritën në aspektin socio-ekonomik;

2.2.7. Mundësimi i çdo lloj përkrahjeje për ngritjen dhe zhvillimin e shtetit në aspektin ekonomik, demokratik, të së drejtës dhe aspektit social si dhe realizimin e të gjitha punimeve me qëllim të ngritjes së kualitetit të mirëqenies së komunitetit,

2.2.8. Në sferën ndërkombëtare, realizimi i aktiviteteve në përputhje me interesat kombëtare dhe komuniteteve, përfaqësimi i shtetit tonë në sferën ndërkombëtare në mënyrën më të mirë si dhe të mundësojë raporte të mira me shtetet fqinje dhe ato të jenë të vazhdueshme,

2.3. **Programi i Partisë** - përmes objektivave të reja politike që janë iniciuar nga 'Lëvizje Novatore' do të bëhemi nismëtarë të fillimit të një epoke të re në politikën Turke të Kosovës, para se gjithash partia i realizon të gjitha punimet dhe aktivitetet politike me qëllim që njeriu të jetë prioritet dhe të respektohen të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, kontribuojnë në përvetësimin e parimeve të së drejtës universale që e ruajnë rendin demokratik dhe kontribuon në procesin e demokratizimit të shtetit, mundësi e zhvillimit dhe ngritjes në arsim, shëndetësi dhe ekonomi, përkrahja për zhvillimin e faktorëve prodhues dhe të kapitalit dhe të bëjë çmos që në politikën e brendshme dhe të jashtme të kemi një shtet të fuqishëm, stabil dhe paqësor.

Parimet dhe të drejtat themelore

Neni 3

Të gjithë anëtarët e partisë duhet të jenë të respektueshëm si dhe në harmoni me parimet dhe të drejtat e theksuara si në vazhdim:

1. *Parimi i detyrimeve* - Çdokush që është anëtar i partisë e ka detyrim që punimet t'i zhvillojë në përputhje me parimet, qëllimet dhe objektivat themelore të përvetësuar nga statuti dhe programi i partisë, t'i përmbahet rendit të partisë dhe të jetë besnik ndaj partisë. Çdo anëtar është i detyruar që të sillet në përputhje me qëllimin e partisë dhe të privohet nga sjelljet që vështirësojnë ose e pengojnë realizimin e qëllimit të saj.
2. *E drejta e votës* - Nëse nuk ka kundërshtime, vendimet e kryesisë merren me shumicën absolute të anëtarëve që marrin pjesë në mbledhje. Duke u bazuar në parimin e demokracisë brenda partisë, çdo anëtar ka vetëm një të drejtë vote; anëtari është i obliguar që votën ta përdor vet.
3. *Parimi i përgjegjësisë* - Vendimet zyrtare që merren duhet të zbatohen dhe të respektohen nga të gjithë anëtarët e partisë dhe zyrtarët e saj. Zyrtarët janë të detyruar të japin informata për fatin e vendimeve të marra.
4. *Parimi i fshehtësisë* - Procedurat e ngritjes, zgjedhjes dhe të emërimit brenda administratës së partisë dhe kryesisë bëhen me vota të fshehta.
5. Të gjithë anëtarët kanë të drejtën të zgjidhen dhe të emërohen në detyrat e partisë. Metoda dhe parimet e zgjedhjes, emërimit, dorëheqjes dhe të largimit nga detyra, rregullohen me Rregullore.
6. *E drejta për t'u zgjedhur* - Çdo anëtarë, ka të drejtë kandidimi vetëm në dy mandate njëri pas tjetrit, por njëkohësisht kandidati mund të tërhiqet dhe sërish të merr përsipër detyrën e njëjtë politike. Pas përfundimit të dy mandateve, e ka të rezervuar të drejtën e emërimit ose zgjedhjes në detyra të tjera.
7. *Parimi i përfaqësimit* - Çdo anëtarë ka të drejtën e pjesëmarrjes në aktivitetet dhe në udhëheqjen e partisë. Përveç kryetarit të përgjithshëm, zëvendësve dhe kryetarëve të degëve, një anëtar në të njëjtën kohë nuk mund të merr pjesë në dy kryesi.
8. *Parimi i barazisë* - Anëtarët e Partisë e gëzojnë të drejtat e barabarta. Partia nuk bën dallime tek anëtarët për nga gjuha, raca, ngjyra, gjinia, feja, fraksioni, familja, klani apo shtresa; nuk ka praktika me të cilat prishet barazia ose që disave prej tyre t'iu njihet një veçori e caktuar.
9. *Liria e shprehjes* - Anëtarët e partisë e kanë lirinë e shprehjes në çështjet e punimeve të partisë dhe në aktivitetet e përfaqësuesve të partisë. Anëtarët mendimet e tyre të lira mund

t'i shprehin në organet e partisë, ata gjithashtu kanë mundësi të marrin pjesë në mbledhjet përkatëse të partisë, të bëjnë kërkesë, të kundërshtojnë dhe të akuzojnë.

KAPITULLI I DYTË

ANËTARËSIA NË PARTI dhe TË DREJTAT E ANËTARIT

Kushtet për të qenë anëtar i partisë

Neni 4

Përveç atyre për të cilët është bërë e qartë se nuk mund të jenë anëtarë të partisë sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ligjeve përkatëse dhe normave legislative, anëtarë i partisë mund të bëhet çdokush që i pranon kushtet e poshtë-shënuara dhe Deklaratën për regjistrim si anëtar:

- a) Përvetësimi i Statutit dhe programit të partisë, pranimi i qëllimeve dhe objektivave të partisë si dhe qëndrimi besnik ndaj parimeve dhe të drejtave themelore me normat e metodës së punës;
- b) Derisa është anëtar i partisë me dijen dhe bagazhin e tij duhet të kontribuojë dhe ta mbështetë partinë;
- c) Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- ç) T'i ketë mbushur 18 vjet dhe të jetë kompetent për aktivitete të ndryshme;
- d) Të ketë të drejtën të jetë anëtar i partive politike, sipas sistemit legjislativ të Kosovës;
- e) Të mos jetë i regjistruar si anëtar në ndonjë parti tjetër;
- f) Të zotohet se do ta paguajë rregullisht anëtarësinë në parti;
- g) T'i pranojë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë që rregullohen me normat e nenit të 9-të;

Aplikimi për anëtarësim, dokumentet që kërkohen dhe procedurat e anëtarësimit

Neni 5

5.1. Individu i cili i zotëron kushtet e anëtarësimit, duke e plotësuar pa mungesa Deklaratën për regjistrim si anëtar te Përfaqësia, Dega apo Qendra, është i ngarkuar që atë ta nënshkruajë vet dhe ta dorëzojë te institucioni kompetent ose te zyrtari partiak.

5.2. Personi i cili aplikon për anëtarësim, krahas Deklaratës për regjistrim si anëtar, në aplikim duhet ta shtojë edhe kopjen e letërnjoftimit.

5.3. Institucioni kompetent ose zyrtari partiak, analizon aplikimin dhe dokumentet, individit që aplikon ia jep vërtetimin për pranim të aplikimit dhe e nis procesin e anëtarësimit.

5.4. Aplikimi për anëtarësim mund të bëhet në format siç janë; interneti, posta apo të ngjashme. Pozita kompetente ose zyrtari partiak i analizon aplikimin dhe dokumentet, palës tjetër ia dërgon vërtetimin për pranim dhe e fillon procedurën e anëtarësimit.

Marrja e vendimit lidhur me aplikimin për anëtarësim

Neni 6

6.1. Që nga data kur prej Kryesisë së Degës ose Sekretariatit të përgjithshëm pranohet aplikimi për anëtarësim, vendimi duhet të merret më së voni brenda tridhjetë (30) ditësh.

6.2. Nëse është pranuar Aplikimi; në ‘Fletoren për regjistrim të anëtarit’ (FRA) dhe ‘Sistemi i regjistrimit të anëtarëve’ (SRA) shënohet data e vendimit dhe numri i anëtarit dhe personit që e bën aplikimin dhe më pas i jepet Vërtetimi Identifikues i Anëtarit (Libreza e anëtarësisë).

6.3. Nëse individi që aplikon i merret vendimi për refuzim të aplikimit, pas marrjes së informatës lidhur me vendimin, ai ka të drejtë brenda dhjetë (10) ditësh, ta shpreh mospajtimin e tij duke e dërguar këtë në Kryesinë qendrore ose në Qendrën e përgjithshme. Për këtë mospajtim, Kryesia Qendrore merr vendim në mbledhjen e parë të rregullt ose më së voni në mbledhjen e dytë të rregullt, pasi që ta ketë analizuar problematikën për të cilën bëhet fjalë. Vendimi që merret nga kryesia është i prerë dhe palëve i përcillet dhjetë ditë pasi që të merret.

‘Fletorja për regjistrim të anëtarit’ (FRA) dhe ‘Sistemi i regjistrimit të anëtarëve’ (SRA)

Neni 7

7.1. Data baza e anëtarit regjistrohet në Përfaqësi, në Degë dhe në Qendrën e përgjithshme në (FRA) dhe arkivohet në mjedis virtual.

7.2. Në (SRA) regjistrimi bëhet si në vijim; anëtarët e anëtarësuar në parti që kanë dalur nga anëtarësimi ose janë përjashtuar, pagesat e anëtarësisë, informatat e anëtarëve, vendimet që partia i merr për anëtarët, anëtarët e kryesisë, organeve dhe komisioneve si dhe informatat për njerëzit zyrtarë ose kompetent.

Vërtetimi identifikues i anëtarit (Libreza e anëtarësisë)

Neni 8

8.1. Vërtetimi identifikues i anëtarit nuk vlen për ndonjë qëllim tjetër, përveç dëshmimit të anëtarësisë në parti. Posedimi me vete i këtij dokumenti është i obliguar kur organizohen zgjedhje brenda partisë, gjatë zgjedhjes së anëtarit dhe zgjedhjes së të tjerëve, në procedurat dhe punimet zyrtare që bëhen për përfaqësim të partisë.

8.2. Vërtetimi identifikues i anëtarit përgatitet në formatin që caktohet nga Sekretariati i përgjithshëm.

8.3. Kompetenca për nënshkrim të Vërtetimit identifikues së anëtarit, i takon kryetarit të degës ku është bërë aplikimi kurse në qendër këtë të drejtë e ka Sekretari i përgjithshëm. Ky vërtetim duhet t'i dorëzohet personit që pranohet si anëtarë i partisë.

8.4. Në situata të veçanta pas Vendimit të Kryesisë së Përgjithshme, anëtarëve të partisë ju jepet titulli 'Anëtar i nderit'.

Të drejtat, obligimet dhe detyrimet e anëtarëve **Neni 9**

9.1. Duke u bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet e saj, Statutin dhe Programin e partisë, çdo anëtar ka të drejtë të jetë kandidat për të gjitha postet e partisë, të merr obligim dhe ta përfaqësojë atë.

9.2. Nëse nuk është caktuar ndryshe, gjashtë (6) muaj pas shpalljes së zgjedhjeve brenda partisë, anëtarët që janë në (SRA) e kanë të drejtën të zgjidhen dhe të zgjedhin.

9.3. Anëtarët e partisë anëtarësinë e paguajnë rregullisht vlerën, e cila vendoset nga ana e Kryesisë qendrore.

9.4. Si rezultat i cilitdo vendim që merret nga cilido organ i partisë, në rast se një anëtar zgjidhet ose emërohet me detyrë në ndonjë post, titull ose pozitë, duke qenë në përputhje me metodën që caktohet prej Kryesisë qendrore, nga pagesa ose rroga që e merr, një sasi të saj ia dhuron partisë. Të gjithë anëtarët e partisë trajtohen si individë që e kanë pranuar këto para dhe partia për ata të merr një vendim të tillë.

9.5. Anëtarët e partisë në përputhje me rregullat e këtij statuti, e kryejnë pagesën e "Anëtarësisë" në vlerën për të cilën vendos Këshilli Ekzekutiv Qendror.

9.6. Anëtarët e partisë, në përputhje me normat ligjore, mund të dhurojnë për partinë mjete materiale ose gjësende.

9.7. Anëtarët të cilët për çfarëdo arsye e ndërrojnë adresën e banimit, janë të obliguar që zyrtarëve partiakë t'u japin informata për ndërrim të vendbanimit ku kanë qenë dhe ku ndodhen tani.

9.8. Anëtarët e partisë janë të detyruar që kërkesat dhe ankesat të cilat vijnë nga populli, t'ia përcjellin organeve kompetente të partisë kështu duke përcjellur procesin t'i informojnë individët përkatës.

9.9. Anëtarët e partisë marrin detyrime aktive në zgjedhjet brenda partisë, zgjedhjet lokale dhe në ato për deputetë. Në këto raste partia mund të përfitojë nga dija dhe përvoja e anëtarëve të partisë.

9.10. Anëtarët janë përgjegjës që të marrin pjesë në mbledhjet e kryesisë dhe punimet e partisë, ku kanë detyrime dhe t'i kryejnë obligimet që i marrin.

9.11. Anëtarët e partisë duhet ta respektojnë kulturën e partisë dhe unitetin e saj, dhe për pavarësinë dhe unitetin e shtetit të punojnë me entuziazëm dhe vendosshmëri si dhe të jenë aktiv në përputhje me vetëdije mbi përgjegjësinë.

9.12. Për informimin, përcjelljen e shpalljeve, e lajmërimeve nga organet e partisë te anëtarët e partisë përdoren numrat e telefonit, adresa e vendbanimit dhe email adresa e fundit të cilën e ka paraqitur anëtari.

9.13. Shkeljet disiplinore që nuk përputhen me anëtarin e partisë, përcaktohen nga ana e Kryesisë qendrore, duke e marrë edhe miratimin e Këshillit disiplinor, por çdoherë në përputhje me Rregulloren që i trajton çështjet e Shkeljeve disiplinore.

Përfundimi i anëtarësimit

Neni 10

Përfundimi i anëtarësimit ne parti mund të bëhet në këto raste:

10.1. Vdekje,

10.2. Dorëheqje,

10.3. Anëtarësim në ndonjë parti tjetër,

10.4. Kandidimi në zgjedhje prej ndonjë organizimi tjetër politik ose si kandidat i pavarur,

10.5. Marrja e detyrimeve në ndonjë parti tjetër politike,

10.6. Në rast të përjashtimit nga partia prej Këshillit qendror disiplinor, përfundon anëtarësia. Në këtë rast bëhet edhe largimi i tij/e saj nga FRA dhe SRA njëkohësisht ai/ajo informohet për këtë gjë.

10.7. Për dëshmimin e dorëheqjes nga anëtarësia, deklarata me shkrim duhet të bëhet nga vet personi dhe kjo është e mjaftueshme. Në deklaratën për dorëheqje duhet të vërtetohet nënshkrimi i personit në fjalë.

10.8. Përveç dispozitave 10.1, 10.2, 10.3, 10.4, 10.5 dhe 10.6 të këtij neni, regjistrimi i anëtarit fshihet me vendim të Kryesisë së degës për ata që më pas i kanë humbur të drejtën për të qenë anëtarë dhe ata që nuk i kanë zotëruar kushtet e anëtarësisë gjatë procesit të regjistrimit të anëtarit/es. Pasi që të fshihet anëtarësia në parti vendimi më së voni brenda dhjetë (10) ditësh iu bartet atyre që ju është fshirë anëtarësia. Individit përkatës brenda dhjetë (10) ditësh pasi ta merr këtë vendim ka të drejtë të bëjë ankesë me shkrim te Këshilli Ekzekutiv Qendror. Këshilli Ekzekutiv Qendror merr vendim në mbledhjen e parë të rregullt ose më së voni në të dytën duke

e analizuar të vërtetën. Vendimi që e merr Kryesia Qendrore është i prerë dhe që prej datës kur është marrë brenda dhjetë (10) ditësh i konfirmohet palëve përkatëse.

KAPITULLI I TRETË STRUKTURA E ORGANIZATËS PARTIAKE

Organet e partisë, Këshillat dhe Përfaqësitë

Neni 11

11.1. Partia me qëllim të arritjes së qëllimeve dhe objektivave që janë në kuadër të Statutit dhe Programit, përbëhet nga organet e organizatës, Këshillat dhe Këshillat anësorë.

11.2. Partia, me qëllim të arritjes së qëllimeve dhe objektivave që janë në kuadër të Statutit dhe Programit, në raste të nevojshme, me vendim të Këshilli Ekzekutiv Qendror mund të themelohen edhe Përfaqësitë, Këshillat anësore dhe Këshillat e punës.

11.3. Organizimi i degës

11.3.1. Kuvendi i degës

11.3.2. Kryetari i degës dhe zëvendëskryetarët e degës

11.3.3. Kryesia e degës

11.3.4. Sekretari i degës

11.3.5. Këshilli disiplinor i degës

11.4. Organizimi i Qendrës së Përgjithshme

11.4.1. Kuvendi qendror – KQ

11.4.2. Kryetari i Përgjithshëm dhe Zëvendësit e Kryetarit të Përgjithshëm – KP dhe ZKP

11.4.3. Sekretari i Përgjithshëm – SP

11.4.4. Këshilli Ekzekutiv Qendror – Kryesia Qendrore

11.4.5. Këshilli Qendror Disiplinor – KQD

11.4.6. Statuti dhe Këshilli Konsultativ – SKK

11.4.7. Këshilli për Buxhet dhe Shërbime Financiare - KBSHF

11.6. Organet ndihmëse - Forumi i Gruas dhe Forumi Rinor

Këshillat Ndihmëse dhe Këshillat e Punës

Neni 12

12.1. Qendra e Përgjithshme themelohet në Prizren, kurse themelimi i degëve bëhet në komunitet tjera. Vendimi për themelimin ose mbylljen e degëve, zbatohet nga ana e Këshillit Qendror Ekzekutiv, por pas marrjes së mendimit edhe të Këshillave të tjerë.

12.2. Kryesia Qendrore me qëllim të zbatimit të programit të partisë dhe ekzekutimin në terren të aktiviteteve politike, pasi që e merr edhe mendimin e organeve tjera të partisë, mund të themelojë Këshilla të ndryshëm ndihmës.

KAPITULLI I KATËRT

ORGANIZIMI I DEGËS

Kuvendi i degës

Neni 13

13.1. Koha kur do të bëhen kuvendet e degëve, vendoset në korniza të planifikimit kohorë e cila caktohet nga Kryesia qendrore duke u marrë mendimi i Kryesisë së degës.

13.2. Kuvendi i degës s'mund të jetë me më shumë se 61 delegatë.

13.3. Anëtarët (delegatët) që duan të jenë kandidatë në organet e partisë, janë të detyrueshëm që ta kenë statusin e Kuvendit të degës. "Statusi i Anëtarit të kuvendit", caktohet me anë të Rregullores që nxirret nga Kryesia Qendrore.

13.4. Parimet dhe metodat e procesit të organizimit të Kuvendit të Degës, caktohen përmes "Rregullores së Zgjedhjeve të Kuvendit.

13.5. Kryesia Themeluese e degës, në komunat në të cilat do të krijohet organizim i ri, nga Kryesia qendrore e merr statusin e kryesisë themeluese të degës. Kryesia themeluese e degës, deri në organizimin e kuvendit të degës dhe në realizimin e zgjedhjeve të reja, detyrën e kryen me të drejtat dhe kompetencat që i ka. Numri i nevojshëm i anëtarëve për themelim të degës është 50.

Strukturimi i Degëve

Neni 14

14.1. Hapja e ndonjë dege ose mbyllja e saj bëhet me rekomandim të Këshillit Qendror Ekzekutiv dhe me vendim të Këshillit të përgjithshëm.

14.2. Kuvendi i degës, Kryesia e degës, Kryetari i Kryesisë së Degës, Zëvendës kryetari i kryesisë së degës dhe Sekretari i degës, e përbëjnë strukturën politike të degës; forumi i grave të degës, forumi rinor i degës, komisionet anësore dhe nën komisionet, njësitë dhe përfaqësitë e përbëjnë strukturën e organizimit të degës.

Kryetari i Degës

Neni 15

15.1. Kryetari i degës dhe zëvendësi i kryetarit të degës që e rekomandon ai, zgjidhen drejtpërdrejtë në Kuvendin e degës me vota të fshehta dhe me shumicë votash. Kryetari i degës njëkohësisht është Kryetari i kryesisë së degës.

15.2. Kryetari i degës nga brendia e kryesisë së degës e bën shpërndarjen e detyrave dhe kompetencave mes anëtarëve, në rast se mungon kryetari i degës, këtë detyrë e kryen zëvendëskryetari i degës, por në raste kur mungon edhe ai atëherë detyrën e kryetarit e bën një anëtar që është kompetent për këtë punë.

15.3. Kryetari i degës e përfaqëson partinë brenda komunës. E përgatit planin dhe rendin e ditës së kryesisë, vendimet që merren në qendër ia përcjell kryesisë së degës, i organizon mbledhjet dhe përfaqësitë që janë të lidhura me degën dhe organizimet e tjera i monitoron dhe i ekzekuton punimet në emër të degës.

15.4. Kryetari i degës luan rol aktiv për realizimin e qëllimeve dhe objektivave që caktohen në Statut dhe Program, e mundëson që aktivitetet e partisë të jenë të suksesshme dhe efektive, punimet efektive dhe produktive gjithashtu realizon edhe me përfaqësuesit e partisë në komunë, nëpunësit që punojnë në administratë, organizatat joqeveritare, udhëheqësit e partive të tjera, përfaqësuesit e botës së biznesit dhe kryetarët e degëve të tjera.

15.5. Kryetari i degës i ekzekuton të gjitha aktivitetet politike dhe partiake në zgjedhjet e përgjithshme parlamentare dhe ato komunale që procesi i zgjedhjeve të kalojë i suksesshëm dhe i shëndoshë.

15.6. Kryetari i degës, një herë në vit e organizon kuvendin e degës me qëllim të raportimit të punimeve vjetore dhe raporteve financiare.

Zëvendëskryetari i Degës

Neni 16

16.1. Zëvendëskryetari i degës, i kryen detyrat me të cilat është ngarkuar nga kryetari i degës dhe në rastet kur nuk prezanton kryetari i degës, e zëvendëson atë.

16.2. Zëvendëskryetari i degës, me rekomandimin e kryetarit të degës, zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë në Kuvendin e degës. Kryetari i degës dhe zëvendëskryetari i degës, zgjidhen në përputhje me parimin e barazisë gjinore.

16.3. Zëvendëskryetarit të degës, detyrat dhe përgjegjësitë, fushat e veprimit dhe kompetencat iu caktohen nga kryetari i degës.

Struktura e Kryesisë së Degës

Neni 17

17.1. Mandati i Kryesisë së re të zgjedhur është (4) vjet. Metoda e identifikimit të listës së hapur apo të mbyllur, përcaktohet me shumicën e votave që merren në kuvendin e degës.

17.2. Kryesia e degës përbëhet nga 7 e deri në 15 anëtarë dhe zgjedhet me vota të fshehta. Në zgjedhjet e njëjta më së paku zgjidhen pesë (5) anëtarë rezervë.

17.3. Struktura e Kryesisë së degës duhet të jetë në përputhje me parimin e barazisë gjinore së paku në nivelin 1/3.

17.4. Kompetencat dhe detyrat e Kryesisë së degës, fushat e aktivitetit dhe të punimeve, caktohen nga Rregullorja e punës së Kryesisë së degës.

Sekretari i Degës

Neni 18

18.1. Sekretari i degës është i ngarkuar dhe përgjegjës që t'i mbajë dokumentet, informatat, shënimet dhe dosjet sipas metodës së duhur në përputhje me ligjet, statutin e partisë dhe rregulloret si dhe për realizimin në mënyrë të shëndoshë të komunikimit brenda partisë.

18.2. Detyrën e Sekretarit të degës e merr anëtari i partisë i cili ka njohuri juridike, administrative dhe financiare, që e ka përvetësuar Statutin dhe programin e partisë, që i zotëron rregulloret dhe metodat, parimet e organizimet brenda partisë, që është edukuar brenda kuadrove të partisë, që është punëtor, i kualifikuar, që i di mirë gjuhët zyrtare, që nuk punon në mënyrë aktive në ndonjë detyrë ose post tjetër dhe që mund ta kryejë këtë detyrë me meritë.

18.3. Kryetari i degës, procesin e nis duke u bazuar në parimin e meritokracisë. Emërimi i tij bëhet duke u marrë miratimi i Kryesisë së degës dhe Sekretarit të përgjithshëm, në përputhje me parimet dhe kushtet e aplikimit për punë, duke e zgjedhur njërin nga tre kandidatët më të përshtatshëm.

18.4. Detyrat e Sekretarit të degës, kompetencat dhe mandati i punës, metodat e punës, rroga dhe detyrimet e tjera, të drejtat dhe përgjegjësitë, caktohen me Rregulloren që nxirret nga Kryesia qendrore.

18.5. Sekretari i degës, në kuadër të detyrës dhe obligimeve, i jep përgjegjësi Kryetarit të degës dhe Sekretarit të përgjithshëm.

Këshilli Disiplinor i Degës

Neni 19

19.1. Këshilli disiplinor i degës zgjidhet me vota të fshehta në kuvendin e degës për mandat 4 vjeçar. Këshilli disiplinor i degës, përbëhet nga tre anëtarë kryesorë dhe dy anëtarë rezervë. Këshilli disiplinor kryetarin e zgjedh në mbledhjen e tij të parë, brenda një jave pas zgjedhjeve.

19.2. Për të qenë kandidat për Këshillin disiplinor të degës, duhet të mos kesh marrë më parë ndonjë dënim disiplinor, të mos jesh aktiv në ndonjë detyrë brenda strukturës aktuale dhe të zotërosh njohuri juridike dhe administrative.

19.3. Kryesia e degës, punimet e saj i ekzekuton duke u mbështetur në parimet : “Rregullorja e Këshillit disiplinor të partisë.”

Strukturimi i Qendrës së Përgjithshme të Partisë

Kuvendi Qendror

Neni 20

20.1. Kuvendi Qendror i rregullt bëhet njëherë në katër vjet dhe agjenda e Kuvendit Qendror përgatitet nga Këshilli Ekzekutiv Qendror.

20.2. Këshilli Ekzekutiv Qendror është përgjegjëse për përgatitjen e agjendës në përputhje me ligjet dhe statutin e partisë. Radha e pikave të rendit të ditës, mund të ndryshohet nga propozimi i një të dhjetave të delegatëve dhe me vendimin e shumicës së pjesëmarrësve në kuvend, ose rendit të njëjtë të ditës mund t’i shtohen pika tjera.

20.3. Numri i delegatëve të Kuvendit Qendror, duke u marrë për bazë viti i organizimit të Kuvendit Qendror, nuk mund të jetë më i madh se totali i anëtarëve të Kryesive së degëve.

20.4. Me qëllim të udhëheqjes së Kuvendit Qendror, me shumicë votash zgjidhet Komisioni i punimeve të kuvendit që përbëhet nga pesë (5) anëtar. Komisioni brenda vetës zgjedh për kryetar një anëtar. Me qëllim që Komisionit të punimeve të kuvendit të ndihmohet teknikisht nga punëtorët e partisë zgjidhet edhe një grup prej 3 vetash.

20.5. Statusi i Anëtarit në Kuvendin qendror, caktohet nga Rregullorja e zgjedhjeve të Kuvendit Qendror e cila përgatitet nga Këshilli Ekzekutiv Qendror.

20.6. Procesi i organizimit të Kuvendit qendror, metodat e ftesës, parimet dhe metodat e kuvendit, përcaktohen me anë të Rregullores së zgjedhjeve të kuvendit që përgatitet nga Këshilli Ekzekutiv Qendror.

Detyrat dhe Kompetencat e Kuvendit Qendror

Neni 21

21.1. Kuvendi qendror është organi më i lartë i partisë që është kompetent dhe përgjegjës për të marrë vendime. Kuvendi qendror në korniza të Statutit dhe programit të partisë ka kompetenca

që të merr vendim të prerë për të gjitha punimet dhe për politikat e partisë në nivel kombëtar dhe në nivelin shoqëror.

21.2. Detyrat dhe kompetencat kryesore të Kuvendit qendror janë këto:

- a) Kuvendi qendror i analizon, diskuton dhe i miraton raportet e aktiviteteve të partisë, ato financiare dhe atë të auditorit, jep mendimin e vet dhe i miraton ato. Madje i diskuton dhe i miraton planifikimet e buxhetit të partisë.
- b) Kryetari i Partisë dhe zëvendësit të tij të cilët rekomandohen nga kandidati për Kryetari, zgjedhën me votim të fshehtë dhe me shumicë absolute.
- c) Përveç anëtarëve që marrin pjesë në Këshillin Qendror Ekzekutiv, 5 anëtarë të tjerë do të zgjidhen me votim të fshehtë.
- d) Pas rekomandimit të Këshilli Ekzekutiv Qendror, vendoset për hapjen ose mbylljen e degëve të reja.
- e) Emrat që do të jenë të ngarkuar me detyrë në Këshillin qendror disiplinor, zgjidhen sipas parimit të votës së fshehtë.
- f) Emrat që do të jenë pjesë e Statutit dhe Këshillit konsultativ, i zgjedh sipas parimit të votës së fshehtë.
- g) Emrat që do të jenë pjesë e Buxhetit dhe në Këshillin e shërbimeve financiare, zgjidhen sipas parimit të votës së fshehtë.
- h) Nëse shihet e nevojshme, partisë mund t'i ndryshohet Statuti, Programi dhe Emri.
- i) Dënimet që i jep Këshilli disiplinor për të gjitha nivelet e partisë, mund edhe të falen, nëse është në dobi të partisë si dhe për ndonjë situatë të veçantë të palës përkatëse,
- j) Në rast se ndodh që partia të shuhet, të bashkohet me ndonjë parti tjetër, ose të përfundojë juridikisht për pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme të partisë dhe për të drejtat e saj vendosin parimet dhe rregullat e shuarjes së partisë.
- k) Vendos për anëtarësimin e partisë në organizatat ndërkombëtare dhe federatat.

Thirrja e Kuvendit Qendror të Jashtëzakonshëm Neni 22

22.1. Thirrja e Kuvendit qendror të jashtëzakonshëm bëhet në këto situata:

- a) Kërkesa me shkrim e 2/3 të Kuvendit qendror,
- b) Vendimi i Këshilli Ekzekutiv Qendror
- c) Dorëheqja ose vdekja e kryetarit të përgjithshëm,
- d) Në situata urgjente ose pas kërkesës së kryetarit të përgjithshëm për agjendën e shtetit,
- e) Kërkesa e arsyetuar e Statutit dhe Këshillit konsultativ dhe
- d) Shpallja e zgjedhjeve të jashtëzakonshme.

22.2. Më së voni brenda 45 ditësh Kryetari i Partisë do ta mbledh Kuvendin qendror.

Zgjedhja, Detyrat dhe Kompetencat e Kryetarit të Partisë Neni 23

23.1. Kryetari i përgjithshëm i partisë, nga Kuvendi qendror zgjidhet për mandat prej 4 (katër) vitesh.

23.2. Kryetari i Partisë e përfaqëson partinë brenda dhe jashtë shtetit.

23.3. Kryetari i përgjithshëm është edhe Kryetar i këshillit ekzekutiv dhe përgjegjës i drejtpërdrejtë ndaj Kuvendit.

23.4. Ai është përgjegjës për realizimin e aktiviteteve në përputhje me Ligjet, Statutin dhe Programin e partisë si dhe ta monitorojë këto.

23.5. Me qëllim që të përfitojë nga dijet dhe përvojat e të tjerëve në çështje të partisë, mund të emërojë edhe Këshilltarë, Këshilla ose Komisione.

23.6. I kryen detyrat e tjera që ia ngarkon Statuti, Rregulloret dhe i përdor të gjitha kompetencat tjera që ia njohin këto.

23.7. Në mungesë të Kryetarit, atë e zëvendëson Zëvendëskryetari i parë, kurse në mungesë të Zëvendëskryetarit të parë atë e zëvendëson Zëvendëskryetari i dytë.

23.8. Kur Kryetari e sheh të arsyeshme konsultohet me anëtarët e partisë dhe mban mbledhje konsultative për punimet e partisë.

23.9. Zëvendësit e Kryetarit, pas rekomandimit të Kryetarit zgjedhën në Kuvendin Qendror.

Këshilli Ekzekutiv Qendror Neni 24

24.1. Anëtarët e përhershëm të Këshilli Ekzekutiv Qendror, Kryetari i përgjithshëm i partisë, Zëvendësit e kryetarit të përgjithshëm, Kryetarët e degëve, Ministrat, Deputetët, Kryetarët e komunave (kur mungon kryetari i komunës, janë zëvendësit e Kryetarit të komunës ose zëvendësit e kryetarit të kuvendit).

24.2. Përveç anëtarëve të përhershëm, me votim të fshehtë për Këshillin Ekzekutiv Qendror zgjedhen 5 anëtarë kryesorë dhe 3 rezervë.

24.3. Pas Kuvendit Qendror, Këshilli Ekzekutiv Qendror është organi më i lartë kompetent dhe përgjegjës ia jep drejtpërdrejtë Kuvendit qendror.

24.4. Mandati i Këshilli Ekzekutiv Qendror është 4 (katër) vite. Mandati iu vazhdon që nga Kuvendi qendror kur janë zgjedhur, deri në Kuvendin qendror të rregullt. Zbrazëtitë që shfaqen

në Kryesinë qendrore për shkak të dorëheqjes ose arsyeve të tjera, plotësohen me anëtarët rezervë, sipas radhës.

24.5. Në rast të dorëheqjes ose të vdekjes së Kryetarit të përgjithshëm të partisë, Këshilli Ekzekutiv Qendror brenda 60 ditësh, e thërret Kuvendin qendror me qëllim të zgjedhjes së Kryetarit të Partisë.

24.6. Këshilli Ekzekutiv Qendror mblidhet pas arritjes së shumicës absolute. Vendimi merret me shumicën e atyre që janë në mbledhje. Në raste të barazisë së votave, merret parasysh vota e kryetarit.

24.7. Çdo anëtarë i cili pa ndonjë arsye nuk merr pjesë 4 herë në mbledhje, trajtohet se ka dhënë dorëheqje.

Detyrat dhe Kompetencat e Këshillit Ekzekutiv Qendror **Neni 25**

Këto janë detyrat dhe kompetencat e Këshillit Ekzekutiv Qendror:

- a) Kryerja e të gjitha detyrave dhe përdorimi i të gjitha kompetencave që ia jep statuti dhe programi i partisë,
- b) Marrja e vendimeve për draft rregulloret që parashihet në Statut dhe i rregullon aktivitetet brenda partisë.
- c) Identifikimi i ndryshimeve të nevojshme në Programin e partisë dhe Statutin e saj, mundësimi i përgatitjes së drafteve për ndryshim dhe marrja e vendimit për hedhje në votim të drafteve që shihen të arsyeshme në Kuvendin qendror.
- ç) Merr vendime për pjesëmarrje ose mos-pjesëmarrje në zgjedhjet e përgjithshme të rregullta ose ato të parakohshme, si dhe në zgjedhjet lokale; identifikon listën e kandidatëve dhe menaxhon procesin e zgjedhjeve.
- d) Vendos për hyrjen në qeveri, të bërit pjesë e qeverisë ose të vendos për largimin nga qeveria.
- e) Ndarja e nevojshme e buxhetit për zgjedhje, realizimin e fushatës zgjedhore dhe punimeve për zgjedhje.
- f) Të merren masat e nevojshme për realizimin e aktiviteteve politike me qëllim të përhapjes në të gjitha shtresat e popullatës, të prezantohen dhe të përvetësohen qëllimet, parimet themelore, objektivat dhe politikat e partisë që janë pjesë e Statutit të partisë dhe programit të saj.
- g) Këshilli Ekzekutiv Qendror është obliguar që t'i rrisë të të hyrat vetanake partisë, t'i monitorojë dhe të udhëheqë çështjet financiare.

h) Pas kërkesës së Kryetarit dhe rekomandimit të tij, vendoset për themelimin e Këshillave anësore dhe komisioneve.

i) Metodatat dhe parimet e punës së Këshilli Ekzekutiv Qendror përcaktohen përmes Rregullores.

Këshilli Qendror Disiplinor – KQD

Neni 26

26.1. KQD, zgjidhet nga Kuvendi Qendror për një mandat prej katër (4) vitesh. KQD formohet nga 5 anëtarë kryesorë dhe 2 rezervë kurse njëri nga ata zgjedhet kryetar. Anëtarët e KQD -së duhet të zotërojnë njohuri juridike, politike dhe të administrimit publik.

26.2. KQD-ja s'mund të bëjë vetë-analizë në mënyrë të drejtpërdrejtë, por në përputhje me Statutin, dosjet që i dërgohen dhe kërkesat që i vijnë i analizon dhe i vendos për ato. KQD-ja është Këshilli më i lartë disiplinor.

26.3. Kompetencat, detyrat, metodatat e parimet e punës së KQD-së përcaktohen me anë të Rregullores që nxirret nga Këshilli Ekzekutiv Qendror.

Këshilli për Statut dhe Konsultim - KSK

Neni 26

26.1. KSK-ja zgjidhet nga Kuvendi Qendror me mandat prej 4 (katër) vitesh. KSK përbëhet nga 5 anëtarë kryesorë dhe 2 rezervë dhe njëri nga ata zgjedhet kryetar. Anëtarët e KSK-së duhet të zotërojnë informata juridike dhe atë të administrimit publik.

26.2. Kryetari i përgjithshëm i partisë, Sekretari i përgjithshëm dhe udhëheqësit përgjegjës për organizimin e partisë, kryetarët e degëve dhe sekretarët e degëve kur e shohin të arsyeshme mund të drejtohen me shkrim në KSK. KSK-ja aplikimin që e merr e analizon brenda 30 ditësh dhe e jep mendimin e vet.

26.3. KSK-ja në bazë të Statutit dhe të Rregulloreve ka kompetenca të komentojë, të jep mendim, të merr vendim dhe të rekomandojë.

Këshilli për Buxhet dhe Shërbime financiare

Neni 27

27.1. KBSHF-ja zgjidhet nga Kuvendi qendror për një kohë prej 4 (katër) vitesh. KBSHF-ja përbëhet nga 3 anëtarë kryesorë dhe 2 rezervë dhe njëri nga ata zgjedhet kryetar. Anëtarët duhet të kenë njohuri për kontabilitet, financa juridike dhe për financat publike.

27.2. Kompetencat, detyrat dhe metodat e parimeve të punës së KBSHF-së përcaktohen me rregullore të nxjerra nga Kryesia qendrore.

Këshillat anësore
Struktura e Forumit të Gruas dhe Forumit Rinor
Neni 28

28.1. Kryesia Qendrore duke e marrë edhe mendimin e organeve tjera të partisë, merr vendim për themelimin e Forumit të gruas dhe atij rinor.

28.2. Themelimi i Forumit të gruas dhe atij rinor, principet e punës dhe sferat e kompetencave, përcaktohen nga Rregullorja për Këshilla anësore që nxirren nga Këshilli Ekzekutiv Qendror.

Burimet Financiare
Neni 29

29.1. Burimet financiare të Partisë janë:

- Të ardhurat nga kuotat e anëtarësisë;
- Të ardhurat nga buxheti i shtetit të akorduara për subjektet politike;
- Ndihmat dhe dhuratat e aktivistëve, të anëtarëve dhe të mbështetësve të Partisë;
- Ndihmat dhe dhuratat e organizatave partnere;
- Zhvillimi i aktiviteteve ekonomike të partisë;
- Çdo pasuri e fituar në mënyrë të paraparë me këtë ligj;

29.2. Buxheti dhe financa menaxhohet nga Këshilli Ekzekutiv Qendror. Kryetari i Partisë është përgjegjës për realizimin e buxhetit. Kryetari mund të emëron ose të autorizon personat përgjegjës për transaksione dhe veprimet financiare.

29.3. Kontrolli, monitorimi dhe mbikëqyrja do të bëhet nga Këshilli për Buxhet dhe Shërbime Financiare dhe nga Kuvendi Qendror.

29.4. Raportet financiare janë transparente për të gjithë anëtarët e Partisë. Çdo vit kalendarik/fiskal duhet të raportohet dhe publikohet në Kuvendin Qendror.

29.5. YTHP do të vepron duke u bazuar dhe respektuar legjislacionin në fuqi, si dhe do të merr të gjitha hapat ligjore sipas ligjit Ligji nr. 03/L-174 Për Financimin e Subjekteve Politike.

KAPITULLLI I PESTË

Normat e Përbashkëta dhe të Përkohshme Neni 30

30.1. Këshilli Ekzekutiv Qendror ka kompetenca që t'i nxjerr të gjitha Rregulloret dhe të ngjashmet që parashihet të nxirren sipas Statutit.

30.2. Kuvendi Qendror vendos që të bëhen ndryshime në Statutin dhe Programin e partisë si dhe të nxirren Rregullore në përputhje me normat.

30.3. Kuvendi Qendror ka kompetenca të merr vendim për shuarjen e partisë. Kërkesa për anulim propozohet me shumicë absolute të atyre që prezantojnë Kuvendin qendror, kurse vendimi merret me 2/3 e votave të fshehta të delegatëve të kuvendit. Ndarja e pasurive të partisë bëhet në përputhje me normat që gjenden në Rregullore.

30.4. Sipas Rregullores së Statutit, Këshilli Ekzekutiv Qendror derisa të strukturoret Kuvendi i parë qendror, i posedon të gjitha të drejtat dhe kompetencat.

30.5. Vendimi i Këshillit të Përgjithshëm themelues dhe regjistrimi zyrtar i partisë si dhe kryerja e procedurave ligjore, këto detyra i ngarkohen Kryetarit të Partisë. Pas marrjes së vërtetimit të regjistrimit zyrtarë nga Komisioni Qendror Zgjedhor, fillon procesi i themelimit të organeve të tjera dhe organizatave të tjera të partisë. Deri në këtë proces, aplikimet për anëtarësim bëhen nga ana e Sekretariatit të përgjithshëm.

30.6. Sa i përket normave që nuk i përfshin ky statut, aplikohen normat të legjislacionit në fuqi.

Data 21 Shtator 2020

Vendi Prizren

Kryetari Ertan Simitçi